**Programi EIDHR i Bashkimit Evropian
për Shqipërinë**

Standartet e Shërbimeve

të Përkujdesit Shoqëror

për Personat me

Aftësi të Kufizuara

Ky projekt është financuar
nga Bashkimi Evropian

Ky projekt implementohet nga
Shoqata "Ndihmoni Jetën"

Shërbimi Social
Shtetëror

Botim i Shoqatës “Nihmoni Jetën”

Për më tepër informacion kontaktoni në:
Adresa: Shoqata “Ndihmoni Jeten”. Fshati Prush. Komuna Vaqarr. Tiranë
Tel: +355 (0)68 20 84945
E-mail: info@helpthelife.org.al
Web-page: www.helpthelife.org
Face book: Help the Life Association

STANDARTET E SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Tiranë, 2014

FALENDERIME

Procesi i hartimit të Standarteve të Shërbimeve te Përkujdesit Shoqëror për Personat me Aftësi të Kufizuar u mundësua nga kontributi i një grupi pune të përbërë nga përfaqësues të organizatave të avokatisë për aftësinë e kufizuar, të subjekteve shtetërore dhe jo fitimprurëse të liçensuara për shërbime për PAK, specialist të Ministrisë së Mirëqënies Sociale e Rinisë, specialistë të Shërbimit Social Shtetëror, specialist të Drejtorisë së Inspektimit të Shërbimit Publik si edhe përfaqësues të pushtetit vendor.

Falenderojmë institucionet dhe organizatat e mëposhtëme për ndihmën dhe pjesëmarrjen:

- **Matilda Tyli** Ministria e Mirëqënies Sociale e Rinisë
- **Nila Prifti** Ministria e Mirëqënies Sociale e Rinisë
- **Arkida Hysenaj** Shërbimi Social Shtetëror
- **Merita Beqiri** Shërbimi Social Shtetëror
- **Ediola Ifti** Shërbimi Social Shtetëror
- **Gazment Zita** Drejtoria e Inspektimit të Shërbimit Publik
- **Vilma Miraka** Bashkia Tiranë
- **Julia Çepi** Bashkia Shkodër
- **Ingrid Trajani** Qëndra “Shtëpia E kuqe”
- **Rajmonda Prifti** Shoqata “Për Gratë e Fëmijët”
- **Afërdita Seiti** Shoqata “Ndihmoni Jeten”
- **Zela Koka** Shoqata MEDPAK
- **Bardhylka Kospiri** Fondacioni Shqipëtar për të Drejtat e PAK
- **Abdulla Omuri** Shoqata e Invalidëve të Punës
- **Eduard Ajaz** Shoqata Kombëtare e Personave që nuk dëgjojnë
- **Erjola Cullufe** Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë
- **Ndrek Ismajli** Shoqata “Shpresë e Dashuri”
- **Hysnie Hashorva** Eksperte lokale

Një falenderim të veçantë **Dr. Marita Nika Flagler,** specializuar në fushën e politikave sociale të aftësisë së kufizuar, që ofroi konsulencen e saj në hartimin e dokumentit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore për PAK, në kuadër të projektit ““Aksesi në shërbime, një e drejtë themelore e personave me aftësi të kufizuar”, një bashkëpunim i Shoqatës “Ndihmoni Jetën” dhe Shërbimit Social Shtetëror, i financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri.

PËRMBAJTAJA E LËNDËS

KREU I.

1 Pse ishte i rëndësishëm plotësimi dhe zgjerimi i standarteve ekzistuese 5
2 Metodologjia e përdorur për hartimin e standarteve 5
3 Parimet kryesore ku janë mbështetur standartet 6

KREU II.

Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror
për personat me aftësi të kufizuara 9

PJESA E PARË

Shërbimet e njësive të qeverisjes vendore 9

Standarti 1:
Përgjegjësitë dhe shërbimet e njësive të qeverisjes vendore
për përkujdesin shoqëror të personave me aftësi të kufizuara..... 9

PJESA E DYTË

Shërbimet komunitare në qendra ditore dhe rezidenciale 15

Standarti 2:
Pavarësia, gjithëpërfshirja dhe vetëvendosja..... 15

Standarti 3:
Trajtimi i barabartë dhe me dinjitet,
mbrojtja nga abuzimi e procesi i ankimimit..... 19

Standarti 4:
Plotësimi i nevojave dhe qëllimeve individuale..... 23

Standarti 5:
Procedura e shërbimeve 29

Standarti 6:
Mjedisi i shërbimit dhe ushqimi 35

Standarti 7:
Kërkesat organizative dhe funksionale..... 39

PJESA E TRETË

Shërbimet e përkujdesit shoqëror në banesën e personit
me aftësi të kufizuara dhe në komunitet 43

Standarti 8:
Shërbimet e përkujdesit shoqëror në banesën e personit
me aftësi të kufizuara dhe në komunitet 43



KREU I

1 PSE ISHTE I RËNDËSISHËM PLOTËSIMI DHE ZGJERIMI I STANDARTEVE EKZISTUESE.

Dokumenti i Standarteve të shërbimeve Shoqërore, i aprovuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.822, datë 6.12.2006, parashikonte "pasurimin me elemente të reja" të këtyre Standarteve pas një periudhe pilotimi njëvjeçar.

Këto përmasa të ndryshimeve qenë të nevojëshme:

- Për të plotësuar kuadrin e standarteve ekzistuese, që qenë hartuar vetëm si një minimum i domosdoshëm
- Për të krijuar hapësirat e nevojshme për të mbuluar shërbime komunitare të reja, që nuk ishin pjesë e Vendimit në fjalë, i cili mbulonte vetëm shërbimet ditore dhe rezidenciale.
- Për të mbuluar me informacion ato problematika të punës me PAK që kishin dalë gjatë zbatimit dhe nuk mund t'i zgjidhte drafti ekzistues.
- Për të pasqyruar një realitet të ri në fushën e të drejtave dhe ndryshimeve ligjore që kishin ndodhur në vend dhe në arenën ndërkombëtare gjatë këtyre 6 viteve të zbatimit të standarteve.

2 METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E STANDARTEVE

Plotësimi dhe zgjerimi i Standarteve ekzistuese dhe realizimi i Standarteve të reja për Shërbimet Shoqërore për PAK kishte si qëllim përmirësimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri.

Amendamentet u hartuan në bazë të parimit të pjesëmarrjes të gjithë grupeve të interesit në bërjen e politikave sociale.

Për të realizuar Draftin e standarteve u ngrit një grup pune i përbërë nga18 persona, me përfaqësues të organizatave të avokatisë për aftësinë e kufizuar, të subjekteve publike dhe jo publike të liçensuara për shërbime për PAK, specialistë të fushës, specialist të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, specialistë të Shërbimit Social Shtetëror, specialist të Shërbimit të Inspektimit, si edhe përfaqësues të pushtetit vendor.

Grupi i punës u ndihmua nga ekspertja ndërkombëtare me origjinë shqiptare, Dr. Marita Nika Flagler, që është e specializuar në fushen e politikave sociale të aftësisë së kufizuar dhe që ka marrë pjesë në hartimin e dokumentit të Standarteve të vitit 2006.

3 PARIMET KRYESORE KU JANË MBËSHTETUR STANDARTET

Gjatë të gjithë punës për hartimin e standarteve janë pasur parasysh disa parime kryesore mbi të cilat janë mbështetur:

1. Mbështetja në legjislacionin ekzistues shqiptar, në Strategjinë Kombëtare për Shërbimet për PAK, të Planit të Veprimit për Konventën (draft) dhe Ligjin Integral (draft), Ligjin Antidiskriminim, në Ligjin 9355 për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore etj.

2. Reflektimi i parimeve të "Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar", të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, dhe të "Konventës të Rehabilitimit Komunitar", të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Në veçanti është bërë kujdes që:
   - Të përforcohet koncepti i shërbimit që vë në qender personin me aftësi të kufizuar.
   - Të përforcohet puna e mbështetur në aftësitë e personit me aftësi të kufizuar dhe të reduktohet ndikimi i modelit mjeksor-defiçitar.
   - Të përshtaten kërkesat e Standarteve me realitetin shqiptar, por pa prekur të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe duke gërshetuar, sa është e mundur, me përvojën ndërkombëtare.

3. Të bëhet zgjerimi dhe plotësimi i Standarteve për të mbuluar shërbime dhe aspekte të pambuluara në standartet ekzistuese duke treguar kujdes që:
   - Standartet jo vetëm të bazohen në legjicionin ekzistues por edhe të japin një shtysë për zgjerimin e tij.

- Zgjerimi dhe plotësimi i standarteve të mos bjerë ndesh me Manualin e zbatimit të standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, i përgatitur nga Shërbimi Social Shtetëror.
- Zbatimi i standarteve të mos ketë efekt financiar fillestar.
- Standartet të mbulojnë pothuaj të gjithë gamën e aspekteve të punës për personat me aftësi të kufizuar, duke qenë të hapura për të lejuar shërbime që tani për tani nuk ekzisojnë por që mund të zhvillohen në të ardhmen.
- Standartet të mbulojnë të gjitha kategoritë e aftësise së kufizuar.
- Standartet të lejojnë në të ardhmen udhëzimet specifke të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, apo të Shërbimit Social Shtetëror sipas natyrës së shërbimit.

Këto standarte do të sjellin ngritjen e cilesisë së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, do të rrisin numrin e personave që do të marrin shërbime dhe do të përmirësojnë pjesëmarrjen në jetën e komunitetit dhe gjithëpërshirjen. Duke qënë se Standartet reflektojnë Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuar si edhe kërkesat e Rehabilitimit Komunitar të Personave me Aftësi të kufizuar të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, ato sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe nxisin shërbime të nivelit bashkëkohor.

KREU II

STANDARTET E SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

PJESA E PARË:

SHËRBIMET E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE

Standarti 1:

Përgjegjësitë dhe shërbimet e njësive të qeverisjes vendore për përkujdesin shoqëror të personave me aftësi të kufizuara

Rezultati përfundimtar i dëshiruar

Njësitë e qeverisjes vendore punojnë së bashku me personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre, asistentët e kujdesit personal apo shoqëruesit që marrin përfitimin e kujdestarisë, interpretët e gjuhës së shënjave dhe organizatat përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara për përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara dhe për parandalimin e shmangien e diskriminimit dhe përjashtimit shoqëror.

Standarti

Njësia e qeverisjes vendore siguron partneritet me personat me aftësi të kufizuara dhe me të gjithë grupet e interesit në fushën e aftësisë së kufizuar mbi bazën e pari-

meve të gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit. Çdo njësi e pushtetit vendor cakton një punonjës të sektorit të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore të ndjekë çështjet e aftësisë së kufizuar dhe të mbështesë personat me aftësi të kufizuara dhe asistentët e kujdesit personal apo shoqëruesit që marrin përfitimin e kujdestarisë.

Kriteret e përmbushjes së standartit dhe provat përkatëse:

Kriteret		Prova që vërtetojnë përmbushjen e kriterit	
1	Njësitë e qeverisjes vendore sigurojnë përfaqësimin e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha partneritetet vendore ku trajtohen çështje që prekin aftësinë e kufizuar.	**1.1**	Numri i personave me aftësi të kufizuara apo i përfaqësuesve të organizatave që mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara në mbledhjet dhe takimet e organizuara nga njësia vendore ku trajtohen çështje që prekin aftësinë e kufizuar.
		1.2	Përshtatjet e arsyeshme të krijuara për të mundësuar pjesëmarrjen aktive të personave që përdorin karroca (nëpërmjet zgjedhjes së mjedisit të përshtatshëm), e personave me probleme shikimi (sipas nevojave, nëpërmjet përgatitjes së dokumentave në Brail, shkrim të zmadhuar dhe reliev ose në formatin audio), e personave që nuk dëgjojnë (nëpërmjet prezencës së një interpreti të gjuhës së shenjave) dhe të personave me aftësi të kufizuara intelektuale (nëpërmjet përgatitjes së teksteve të thjeshtëzuara e me shkrim të zmadhuar).
		1.3	Procesverbalet e mbledhjeve dhe takimeve të njësive vendore ku kanë marrë pjesë persona me aftësi të kufizuara.
2	Njësitë e qeverisjes vendore sigurojnë pjesëmarrjen aktive konsultative të organizatave	**2.1**	Informacioni i shpërndarë tek organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara dhe personat me aftësi te kufizuara mbi planifikimin,

	që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara dhe të vetë personave me aftësi te kufizuara në procesin e planifikimit, hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave dhe shërbimeve që prekin aftësinë e kufizuar.		hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe shërbimeve që prekin aftësinë e kufizuar.
		2.2	Procesverbale të mbledhjeve që tregojnë pjesëmarrjen e organizatave përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara dhe personave me aftësi te kufizuara në procesin e planifikimit, hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave dhe shërbimeve që prekin aftësinë e kufizuar.
		2.3	Intervista me drejtues të organizatave që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara dhe persona me aftësi te kufizuara që tregojnë për pjesëmarrjen e organizatës së tyre në procesin e planifikimit, hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave dhe shërbimeve që prekin aftësinë e kufizuar.
3	Njësitë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me organizatat që mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara dhe subjekte të liçensuara, ngrenë gradualisht, në përputhje me mundësitë e tyre, shërbime të ndryshme që mbulojnë të gjitha grup-moshat, kategoritë e aftësisë së kufizuar si edhe nevojat e ndryshme funksionale në përputhje me moshën.	**3.1**	Harta e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara mbulon shërbime për fëmijë, të rritur e të moshuar të kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.
		3.2	Plani i komunitetit përfshin ngritjen graduale të shërbimeve të shumëllojshme për personat me aftësi të kufizuara të kategorive të ndryshme.
4	Njësitë e qeverisjes vendore mbështesin shërbimet e ofruara nga subjektet e liçensuara dhe sigurojnë cilësinë e tyre.	**4.1**	Sipas mundësive, njësitë e qeverisjes vendore mbështesin financiarisht shërbimet e ofruara nëpërmjet procesit të konkurrimit. Procesi i konkurrimit përfshin edhe vlerësimin e punës së subjekteve te liçensuara në bazë të standarteve të shërbimeve të

			përkujdesit shoqëror të personave me aftësi të kufizuara.
		4.2	Njësitë e qeverisjes vendore sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga subjektet e liçensuara në përputhje me udhëzimet e Shërbimit Social Shtetëror.
5	Çdo sektor i ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki/komunë ka së paku një punonjës me diplomë universitare si specialist i fushës që ndjek çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ofron shërbime të përkujdesit komunitar për aftësinë e kufizuar.	**5.1**	Përshkrimi i punës së punonjësit mbulon si minimum këto çështje të aftësisë së kufizuar: **1.** Takim të rregullt me organizatat që mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara. **2.** Identifikimin në mjedisin ku jetojnë e nevojave te personave me aftësi të kufizuara dhe evidentimin e tyre në dosjen e personit me aftësi të kufizuara. **3.** Raportimin në këshillin e njësise vendore për problematikën e aftësisë së kufizuar dy herë në vit. **4.** Bashkëpunimin me organizatat që mbrojnë interesat personave me aftësi të kufizuara **5.** Sipas nevojës, sigurimin e përshtatjes së mjedisit, materialeve të përshtatura dhe interpretit të gjuhës së shënjave për takime të organizatave të personave me aftësi të kufizuara me pushtetin vendor. **6.** Ndihmën e asistentëve të kujdesit personal apo shoqëruesve, që marrin përfitim kujdestarie, me mbështetje emocionale, referime, avokati për të drejtat e personit me aftësi të kufizuara, trajnim, etj. **7.** Ndihmën e personave me aftësi të kufizuara me mbështetje emocionale, referime, avokati për të drejtat e njeriut, veçanërisht ato

			për arsimim e punësim, koordinim të shërbimeve, etj.
		5.2	Punonjësi i caktuar për aftësinë e kufizuar ka një diplomë universitare në një nga këto fusha: punë sociale, pedagogji speciale, psikologji, ose sociologji.
		5.3	Kualifikimi profesional mbulon njohuritë për aftësinë e kufizuar, të drejtat e njeriut për personat me aftësi të kufizuara, shprehitë e punës për bashkëpunimin me organizatat që përfaqsojnë personat me aftësi të kufizuara dhe mbështetjen e asistentëve te kujdesit personal që marrin përfitim kujdestarie.
		5.4	Kualifikimi i fundit profesional është bërë jo më shumë se një vit përpara.
6	Shërbimet e mbështetjes së familjes dhe asistentit të kujdesit personal apo shoqëruesit që merr përfitimin e kujdestarisë dhe të personave me aftësi të kufizuara sigurojnë cilësinë e jetës, mosdiskriminimin dhe gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në komunitet.	**6.1**	Punonjësi i caktuar për aftësinë e kufizuar viziton personin me aftësi te kufizuar, asistentin e kujdesit personal që merr përfitimin e kujdestarisë dhe anëtarë të tjerë të familjes në banesën e të parit së paku dy herë në vit.
		6.2	Shënimet e vizitës janë në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe përmbajnë mbështetjen e dhënë për realizimin e nevojave të paraqitura.
		6.3	Shërbimet e mbështetjes mbulojnë fushat e mëposhtëme: (a) mbikqyrja e cilësisë së jetës të personit me aftësi të kufizuara, (b) dhënia e mbështetjes emocionale për personin me aftësi të kufizuara dhe anëtaret e familjes, (c) informacioni për shërbimet ekzistuese që ofrohen nga organizata shtetërore dhe private, (d) edukimi i

			familjes për të drejtat e personit me aftësi të kufizuara për t'u përfshirë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore, (d) koordinimi i shërbimeve të ndryshme dhe (e) avokati për personin me aftësi të kufizuara.
		6.4	Punonjësi i caktuar per aftësinë e kufizuar evidenton rastet e abuzimit dhe neglizhencës dhe i raporton ato sipas udhëzimeve përkatëse.
		6.5	Sipas nevojave, punonjësi i caktuar për aftësinë e kufizuar organizon dhe realizon vetë ose në bashkëpunim trajnimin e asistentit të kujdesit personal apo shoqëruesit.
		6.6	Personat me aftësi të kufizuara dhe asistentët e kujdesit personal apo shoqëruesit e intervistuar tregojnë mbështjen e marrë nga njësia vendore.

PJESA E DYTË:

SHËRBIMET KOMUNITARE NË QENDRA DITORE DHE REZIDENCIALE

Standarti 2:

Pavarësia, gjithëpërfshirja dhe vetëvendosja

Rezultati përfundimtar i dëshiruar

Shërbimet shoqërore për personat me aftësi të kufizuara nxisin dhe mbështesin pavarësinë e vetëvendosjen e personave me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrjen e gjithëpërfshirjen e tyre në jetën e komunitetit.

Standarti

Shërbimet e përkujdesjes shoqërore për personat me aftësi të kufizuara u përgjigjen siç duhet kërkesave dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuara për mbështetje për një jetë sa më të pavarur në gjirin e shoqërisë si anëtarë të barabartë. Shërbimet mbështetëse për familjen parandalojnë institucionalizimin dhe sigurojnë integrimin social pas largimit nga institucioni.

Kriteret e përmbushjes së standartit dhe provat përkatëse:

Kriteret		Prova që vërtetojnë përmbushjen e kriterit	
1	Pavarësia e personave me aftësi të kufizuara nxitet në përputhje me aftësitë dhe dëshirat e tyre nga filozofia e shërbimeve si edhe praktika e përditëshme e subjekteve të liçensuara që	1.1	Dokumenti zyrtar i subjektit të liçensuar që ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara shpjegon me një gjuhë të thjeshtë misionin dhe filozofinë e përkujdesjes që nxit pavarësinë e personave me aftësi të kufizuara.

	ofrojnë shërbime në fushën e aftësisë së kufizuar.		
		1.2	Shënimet në dosjen e përfituesve përshkruajnë punën e kryer për nxitjen e pavarësisë. Është e qartë se mbështetja e dhënë rrit potencialin për të realizuar objektivat e përshkruara në planin individual.
2	Filozofia e shërbimeve si edhe praktika e përditëshme e subjekteve të liçensuara që ofrojnë shërbime në fushën e aftësisë së kufizuar nxit dhe mundëson pjesëmarrjen e gjithëpërfshirjen në jetën e komunitetit.	**2.1**	Dokumenti zyrtar i subjektit të liçensuar shpjegon me fjalë të thjeshta e të kuptueshme se shërbimet kanë si pikësynim pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën e komunitetit në përputhje me moshën, kategorinë e aftësisë së kufizuara dhe natyrën e shërbimit të ofruar.
		2.2	Praktika e punës së subjektit të liçensuar tregon se bëhet kujdes që shërbimet të synojnë integrimin dhe gjithëpërfshirjen dhe të ofrohen në mjedise hapësinore dhe shoqërore të integruara apo gjithëpërfshirëse.
		2.3	Intervista me përfituesit apo përfaqësuesit e tyre ligjorë tregon se subjekti i liçensuar bën përpjekje për të siguruar integrimin dhe gjithëpërfshirjen dhe se shërbimet ofrohen sa herë që është e mundur në mjedise të integruara dhe gjithëpërfshirëse.
		2.4	Shënimet në dosjet e përfituesve përshkruajnë pjesëmarrjen në aktivitete të komunitetit në përputhje me moshën dhe interesat e shfaqura.
		2.5	Personave me aftësi të kufizuara apo përfaqësuesve të tyre ligjorë u jepet informacion në një gjuhë dhe /ose format të kuptueshëm për ta.

3	Personit me aftësi të kufizuara i jepet informacion i përshtatur për të drejtat e njeriut për personat me aftësi të kufizuara dhe ai mbështetet për t'i ushtruar këto të drejta.	**3.1**	Subjekti i liçensuar ka informacion me një gjuhë dhe format të kuptueshëm dhe nevojat për komunikim për të drejtat e njeriut për personat me aftësi të kufizuara në përputhje me moshën e përfituesve.
		3.2	Personi i interesuar merr mbështetjen e duhur për të marrë pjesë në organizata avokatie dhe për të luajtur rol udhëheqës. Kjo mbështetje bëhet pjesë e planit individual.
		3.3	Personi i interesuar dhe që përmbush kriteret ligjore merr mbështetjen e duhur për të marrë pjesë në procesin e votimeve në zgjedhje vendore dhe kombëtare. Kjo mbështetje bëhet pjesë e planit individual.
		3.4	Personi merr mbështetje për të ushtruar ritet e fesë së tij. Kjo mbështetje bëhet pjesë e planit individual.
		3.5	Personi i interesuar nga një minoritet kombëtar apo gjuhësor merr mbështetje për realizimin e të drejtave të tij gjuhësore dhe kulturore. Mbështetja e dhënë bëhet pjesë e planit individual.
		3.6	Bëhen përpjekje për të siguruar arsimin në sistemin shkollor të personave të moshës shkollore. Mbështetja e dhënë bëhet pjesë e planit individual.
		3.7	Në përputhje me mundësitë, bëhen përpjekje për të realizuar angazhimin e personave mbi moshën 18 vjeç në veprimtari të formimit profesional, punësimit dhe vullnetarizmit. Mbështetja e dhënë bëhet pjesë e planit individual.

4	Subjektet e liçensuara të shërbimeve respektojnë të drejtën e përfituesve ose përfaqësuesve të tyre ligjorë për të marrë vendime duke krijuar mbështetjen e duhur. Të gjitha procedurat me përfituesit ose përfaqësuesit e tyre ligjorë kërkojnë miratimin e informuar.	**4.1**	Rregullorja e brendshme subjektit të liçensuar shpjegon me fjalë të thjeshta e të kuptueshme procesin e miratimit të informuar dhe vendimmarrjes së mbështetetur si edhe rastet kur përfaqësuesi ligjor mund të marrë vendime në emër të personit me aftësi të kufizuara. Sipas nevojës, ky dokument është përgatitur në format të përshatur.
		4.2	Plani individual përmban punën që bëhet për të zhvilluar aftësitë e personit për vendimmarrjen e mbështetur.
		4.3	Shënimet në dosjen e përfituesve tregojnë punën e bërë për të siguruar, sa herë që është e mundur, pjesëmarrjen e tyre në procesin e vendimmarrjes së mbështetur
5	Familjes së personit me aftësi të kufizuara i jepet mbështetja e duhur për të parandaluar institucionalizimin e personit me aftësi të kufizuara dhe për të siguruar integrimin dhe gjithëpërfshirjen e tij pas largimit nga institucioni.	**5.1**	Subjektet e liçensuara që ofrojnë shërbime rezidenciale nxisin dhe sigurojnë lidhjen dhe marrëdhënien e personave me aftësi të kufizuara me familjet e tyre. Nxitja dhe puna për mbajtjen e lidhjeve është e dokumentar në dosjen individuale.
		5.2	Subjektet e liçensuara, që ofrojnë shërbime rezidenciale për fëmijë me aftësi të kufizuara, kanë si synim de-institucionalizimin e këtyre fëmijëve. Ata edukojnë familjen për të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuara, dhe bashkëpunojnë me sektorin e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në njësinë vendore përkatëse për të siguruar shërbimet e nevojshme komunitare ditore ose në banesë pas largimit nga institucioni.
		5.3	Subjektet e liçensuara që ofrojnë shërbime ditore, japin shërbime

			edukative, këshillimi, dhe informacioni për prindërit për të parandaluar institucionalizimin.
		5.4	Sipas mundësive, subjektet e liçensuara për shërbime ditore dhe rezidenciale përdorin mjediset e tyre ose banesën e personit me aftësi të kufizuara dhe personelin e tyre për të ofruar shërbimin e kujdesit të shkurtër (nga një orë deri në 15 ditë) ose atë të emergjencës për personat me aftësi të kufizuara. Këto shërbime plotësojnë kriterin 6 të Standartit 8.
		5.5	Sektorët e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki/komuna japin shërbime edukimi, informimi, referimi dhe të mbështetjes emocionale për të parandaluar institucionalizimin dhe për të realizuar largimin nga institucioni.

Standarti 3:

Trajtimi i barabartë dhe me dinjitet, mbrojtja nga abuzimi dhe procesi i ankimimit

Rezultati përfundimtar i dëshiruar

Personat me aftësi të kufizuara trajtohen me barazi, dinjitet, e pa diskriminim. Ata mbrohen nga abuzimi, keqtrajtimi dhe neglizhimi. Personat me aftësi të kufizuara dhe/ose përfaqësuesit e tyre ligjorë gëzojnë të drejtën e ankimimit.

Standarti

Personeli i trajton të gjithë personat me aftësi të kufizuara me respekt e pa diferencime. Kujdes i veçantë tregohet që të mos preket dinjiteti i tyre, të mos keqtrajtohen, neglizhohen, ose abuzohen fizikisht, emocionalisht, seksualisht apo nga ana financiare.

Për këtë, ka procedura dhe praktika pune përkatëse që njihen si nga personeli ashtu edhe nga përfituesit e shërbimeve. Ankesat merren me seriozitet dhe trajtohen brenda afateve kohore dhe me efektivitet.

Kriteret e përmbushjes së standartit dhe provat përkatëse:

Kriteret		Prova që vërtetojnë përmbushjen e kriterit	
1	Individët që punojnë me personat me aftësi të kufizuara tregojnë respekt për dinjitetin e tyre në mënyren se si sillen me ta dhe si i trajtojnë në të gjitha bashkëveprimet.	**1.1**	Vëzhgimet tregojnë që çdo person me aftësi të kufizuara trajtohet me respekt gjatë punës, në bashkëbisedim apo kur i jepet ndihmë.
		1.2	Punonjësi flet për personat me aftësi të kufizuara me respekt, dhe e trajton informacionin që ka për ta me konfidencialitet.
		1.3	Gjatë dhënies së mbështetjes për kryerjen e shërbimeve higjenike bëhet kujdes për ruajtjen e intimitetit.
		1.4	Në qendrat rezidenciale, personeli merr leje kur hyn në dhomën e gjumit të personave me aftësi të kufizuara ose kur përdor sende në pronësinë këtyre të fundit.
		1.5	Shprehjet e seksualitetit trajtohen me respekt dhe kujdes në përputhje me moshën e personit.
2	Nuk ka trajtime të diferencuara që nuk lidhen me nevojat.	**2.1**	Të gjithë përfituesit e shërbimeve trajtohen njëlloj, pa shfaqje të favorizimit.
		2.2	Kriteret e të drejtës për të përfituar shërbime të veçanta janë të formuluara qartë. Të gjithë personat e interesuar për shërbimin marrin informacion me shkrim e gojë e sipas nevojes, në formate të përshtatura e në gjuhën e shenjave,

			për kriteret e përfitimit të shërbimeve.
		2.3	Përfituesit e shërbimeve nuk kanë ankesa për trajtimin nga personeli.
3	Personat me aftësi të kufizuara nuk neglizhohen në kujdesin higjenik dhe veshmbathje.	**3.1**	Higjena personale e personave me aftësi të kufizuara është e mirë. Ata janë të larë, të krehur, dhe nuk mbajnë erë të rëndë. Është treguar kujdes për higjenën e gojës.
		3.2	Personat me aftësi të kufizuara janë të veshur në mënyrë të përshtatëshme për motin, me rroba personale që reflektojnë shijet dhe kërkesat e tyre individuale dhe tendencat e kohës.
4	Personat me aftësi të kufizuara mbrohen nga keqtrajtimi dhe abuzimi fizik, emocional, seksual dhe financiar.	**4.1**	Personeli që punon me personat me aftësi të kufizuara duhet të provojë me dëshmi të gjendjes gjyqësore që është i padënuar.
		4.2	Procedurat e punës me personat me aftësi të kufizuara shmangin mundësitë e abuzimit fizik, emocional, seksual dhe financiar.
		4.3	Subjekti i liçensuar ka një dokument që shpjegon çfarë përbën keqtrajtim dhe abuzim fizik, emocional, seksual dhe financiar të personit nga personeli apo personat e tjerë.
		4.4	Individi apo subjekti që administron të ardhurat personale të personit me aftësi të kufizuara apo e ndihmon atë, mban shënime për të gjitha shpenzimet e bëra dhe sa herë që është e mundur edhe faturat përkatëse. Këto shpenzime futen në dosjen personale të personit me aftësi të kufizuara.

		4.5	Ka një proces të raportimit dhe verifikimit të neglizhencës, abuzimit apo keqtrajtimit në të cilin i kushtohet kujdes si personit që raporton abuzimin ashtu edhe personit që akuzohet për të.
		4.6	Personeli merr trajnim për identifikimin dhe raportimin e rasteve të abuzimit.
		4.7	Dokumentacioni që shpjegon abuzimin, procesin e raportimit dhe verifikimit të tij.
		4.8	Kur abuzimi raportohet nga personi me aftësi të kufizuara, ai mbështetet gjatë gjithë procesit të verifikimit nga një anëtar i personelit apo një person i jashtëm.
		4.9	Personat me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë ndihmohen të kuptojnë se ç'është abuzimi dhe si të mbrohen prej tij. Informacioni dhe këshillimi që u jepet personave si të mbrojnë vetëveten është i për-shtatshëm për moshën, gjininë dhe kategorinë e aftësisë së kufizuar.
		4.10	Masat që parashikohen të merren për mbrojtjen e personave nga abuzimi u shpjegohen atyre gjatë procesit të marrjes së miratimit të informuar.
		4.11	Intervistat me përfituesit e shërbimeve ose përfaqësuesit e tyre tregojnë se ata dinë se ç'është keqtrajtimi dhe abuzimi dhe e njohin procesin e raportimit të tij.
5	Ka një procedurë ankimimi të thjeshtë e të qartë, që është e hapur për të gjithë përfituesit dhe familjarët e tyre. Procedura përmban afatet e përgjigjes dhe	**5.1**	Ka një dokument që sqaron procesin e ankimimit me një gjuhë të thjeshtë dhe sipas nevojes në format të përshtatur.
		5.2	Rregullorja e brendshme ka një pjesë për procedurën e ankimimit që përm-

	organet/personat që trajtojnë ankesën.		ban kushtet e konfidencialitetit, afatet e përgjigjes dhe organet/personat që trajtojnë ankesën. Të gjitha ankesat e marra me gojë apo shkrim dhe përgjigjet e dhëna mbahen në një dosje të veçantë.
		5.3	Inspektimi i ankesave të rregjistuara tregon se ato janë trajtuar me seriozitet dhe brenda afatit të duhur.
		5.4	Përfituesit kanë marrë shpjegime se si të përdorin procedurat e ankimimeve dhe janë të qartë për të.
		5.5	Personeli trajnohet për bashkëveprimin me personin që ka ankesa, për të krijuar një kulturë pune të hapur dhe demokratike.

Standarti 4:

Plotësimi i nevojave dhe qëllimeve individuale

Rezultati përfundimtar i dëshiruar

Çdo person me aftësi të kufizuara merr shërbime që plotësojnë nevojat dhe qëllimet e tij për një jetesë sa më të pavarur dhe të integruar në komunitet.

Standarti

Përpara apo gjatë marrjes së shërbimeve, personat me aftësi të kufizuara vlerësohen nga një ekip multidisiplinar ose ndërdisiplinar. Ky vlerësim merr parasysh të gjitha aftësitë e personit dhe pasqyron, sipas rastit, nevojat e tij individuale aftësuese dhe riaftësuese fizike, shëndetësore, psikologjike, njohëse, komunikative, shoqërore, etj. për të jetuar në komunitet dhe për të realizuar funksionet e moshës përkatëse në mënyrë sa më të pavarur. Në bazë të vlerësimit dhe dëshirave e pikësynimeve të personit me aftësi te kufizura ose përfaqësuesit të tij ligjor ndërtohet plani individual, i cili, kur është e nevojëshme, përmban masat për parandalimin dhe trajtimin e çrregullimeve të sjelljes. Ecuria e zbatimit të planit individual vlerësohet rregullisht.

Kriteret e përmbushjes së standartit dhe provat përkatëse:

Kriteret		Prova që vërtetojnë përmbushjen e kriterit	
1	Ka një procedurë të qartë vlerësimi që përfshin së paku fushat e vlerësimit, metodikën e vlerësimit dhe rolin e përfituesit te shërbimeve apo përfaqësuesit të tij ligjor në këtë proces.	**1.1**	Shembuj të vlerësimeve të përfunduara, të firmosura si nga personeli ashtu edhe nga përfituesi/ perfaqësuesi ligjor. Përfituesi zotëron kopje të vlerësimit të tij.
		1.2	Dokumenti që përshkruan procedurën e vlerësimit dhe ngritjen e funksionimin e ekipeve multidisiplinare dhe ndërdisiplinare.
		1.3	Formulari tip për procesin e vlerësimit.
		1.4	Përfituesit e shërbimeve ose përfaqë-suesit e tyre ligjorë konfirmojnë përf-shiren e tyre në procesin vlerësues.
		1.5	Personeli konfirmon përfshirjen e tij dhe të përfituesve të shërbimeve në procesin e vlerësimit dhe mund të flasin për të.
2	Ekipi multidisiplinar ose ndërdisiplinar i vlerësimit për-faqëson nevojat dhe kërkesat specifike të përfituesit. Vlerësuesit janë specialistë të fushës së vlerësuar në komunitet ose pranë subjektit të liçensuar të shërbimeve.	**2.1**	Dokumentacioni tregon që profesionistët që bëjnë vlerësimin u përkasin fushave ku janë identifikuar paraprakisht nevojat dhe kërkesat e personit.
		2.2	Formulari i vlerësimit.
3	Personi me aftësi të kufizuara ose përfaqësuesi i tij ligjor janë pjesëmarrës aktivë në procesin e vlerësimit; mendimi i tyre kërkohet, vlerësohet dhe merret në konsideratë.	**3.1**	Dokumenti që përshkruan procedurën e vlerësimit dhe ngritjen e funksionimin e ekipeve multidisiplinare dhe ndërdisiplinare të vlerësimit përshkruan pjesëmarrjen e personit me aftësi të kufizuara ose përfaqësuesit të tij ligjor.
		3.2	Dokumenti i vlerësimit firmoset nga përfituesi apo përfaqësuesi i tij ligjor.

		3.3	Përfituesi i shërbimeve apo përfaqësuesi i tij ligjorë marrin një kopje të dokumentit të vlerësimit.
		3.4	Intervista me përfituesit e shërbimeve ose përfaqësuesit e tyre ligjorë tregon se mendimi i tyre është kërkuar, vlerësuar dhe marrë në konsideratë dhe se ata e kuptojnë qëllimin e vlerësimit.
4	Procesi i vlerësimit vë në qendër personin me aftësi të kufizura, dhe ndërtohet duke pasur parasysh moshën, aftësitë, nevojat dhe pikësynimet e tij. Sa herë që është e mundur, kryhet në mjedisin e zakonshëm ku kryhet funksioni që vlerësohet.	**4.1**	Dokumenti i vlerësimit tregon se vlerësimi ka pasur parasysh moshën e personit dhe kategorinë e aftësisë së kufizuar.
		4.2	Procedura e vlerësimit përcakton marrjen e mendimit të personit të vlerësuar apo përfaqësuesit të tij ligjor mbi pikësynimet e punës.
		4.3	Intervista me personat me aftësi të kufizuara ose përfaqësuesit e tyre ligjorë tregon se vlerësimi ka pasur parasysh veçoritë e moshës dhe është kryer kur ka qenë e mundur në mjedisin e zakonshëm ku kryhet funksioni që vlerësohet.
5	Vlerësimi evidenton mundësitë dhe aftësitë e indidivit si dhe fushat e nevojës për mbështetje me qëllim që të rritet pavarësia funksionale e personit dhe të mundësohet gjithëpërfshirja në komunitet.	**5.1**	Dokumenti i vlerësimit evidenton mundësitë dhe aftësitë e personit për të kryer veprimet e jetës së përditëshme si edhe funksione të tjera të lidhura me moshën e tij.
		5.2	Vlerësimi i fushave të nevojës për mbështetje përfshinë rritjen e pavarësisë funksionale dhe gjithëpërfshirjen në komunitet.
6	Vlerësimi i plotë bëhet së paku një herë në tre vjet. Vlerësimi i ecurisë bëhet se paku një herë në vit.	**6.1**	Vlerësimi i plotë është bërë jo më pak se tre vjet përpara.
		6.2	Dokumenti i vlerësimit të ecurisë

			është bërë jo më parë se një vit për-para.
		6.3	Vlerësimi mjeksor është bërë jo më pak se një vit përpara.
7	Mbi bazën e vlerësimit bëhet plani individual, që përmban domosdoshmërisht tregues të matshëm të realizimit të objektivave afatgjatë, afatmesëm e afatshkurtër të vendosura për punën me përfituesrfituesin.	**7.1**	Treguesit e realizimit të objektivave afatshkurtër ose afatmesëm në planin individual sipas afateve kohore të përcaktura në plan.
		7.2	Treguesit e realizimit të objektivave janë të matshëm.
		7.3	Personi me aftësi të kufizuara ose përfaqësuesi i tij ligjor marrin një raport ecurie të përpiluar nga subjekti ligjor që kryen shërbimet së paku dy herë në vit për treguesit e realizimit të objektivave.
8	Plani individual përmban mbështetjen që do t'i jepet personit për të siguruar realizimin e objektivave. Objektivat janë të lidhura me rritjen graduale të pavarësisë dhe gjithëpërfshirjen në komunitet.	**8.1**	Plani i individual përfshin punën që do të kryhet nga të gjithë specialistët.
		8.2	Plani individual evidenton burimet e komunitetit që do të përdoren për mbështetje si edhe përdorimin e mjediseve komunitare.
		8.3	Në plan është përfshirë bashkëpunimi i të afërmve, miqve dhe persona të tjerë të rëndësishëm në jetën e personit me aftësi të kufizuara.
		8.4	Plani individual përfshin pjesëmarrjen në aktivitete të përbashkëta me per-sona që nuk kanë aftësi të kufizuara, dhe kontakte të rregullta me bashkë-moshatarët në mjedise komunitare.
		8.5	Plani individual përfshin përshtatjet e arsyeshme dhe/ose përdorimin e teknologjisë ndihmëse ose gjuhës së

			shënjave që mundësojnë gjithëpërfshirjen e personit me aftësi të kufizuara në jetën e komunitetit dhe rrisin pavarësinë e tij funksionale.
9	Sa herë që është e nevojshme, gjatë procesit të vlerësimit dhe hartimit të planit individual, identifikohen nevojat për trajtimin e çrregullimeve të sjelljes dhe krijohet një plan për masat që duhen marrë gjatë episodeve të çrregulllimeve të sjelljes, si edhe punën që duhet bërë për parandalimin dhe uljen e frekuencës së tyre.	**9.1**	Dokumenti i vlerësimit ka një pjesë të veçantë për vlerësimin e çrregullimeve të sjelljes.
		9.2	Plani për masat që duhen marrë gjatë çrregullimeve të sjelljes për të mos lejuar dëmtimin e personit dhe e të tjerëve.
		9.3	Plani përmban si minimum identifikimin e faktorëve që shkaktojnë çrregullimin e sjelljes, dhe metoda të mbështetjes së sjelljes pozitive për parandalimin dhe uljen e frekuencës.
10	Plani për trajtimin e çrregullimeve të sjelljes përmban trajtime dhe kufizime që nuk cënojnë të drejtat e njeriut dhe dinjitetin dhe lirinë e personit me aftësi të kufizuara.	**10.1**	Plani përcakton marrjen e masave të mundshme për të parandaluar manifestimet e çrregullimeve të sjelljes.
		10.2	Masat e planifikuara për parandalimin e çrregullimeve të sjelljes dhe trajtimin e tyre përmbajnë mbështetje të sjelljeve pozitive dhe shpërblime për to.
		10.3	Masat që janë planifikuar për të trajtuar çrregullimet e sjelljes nuk cënojnë dinjitetin e personit dhe nuk përbëjnë dhunë apo keqtrajtim fizik dhe/ose psikologjik.
		10.4	Plani përcakton që trajtimi i rasteve të çrregullimeve të rënda të sjelljes dhe veçimi nuk përdoren si dënim, por si një masë për të parandaluar rrezikun ndaj vetes dhe të tjerëve.
		10.5	Masat që merren për të trajtuar rastet e çrregullimeve të rënda të sjelljes nuk

			përmbajnë asnjë rrezik për jetën dhe shëndetin e personit.
		10.6	Plani parashikon monitorimin e pandërprerë të personit gjatë periudhës së veçimit të tij.
		10.7	Të gjithë personat që trajtojnë çrregullimet e rënda të sjelljes kanë marrë trajnimin e duhur profesional për metodikën e përdorur.
		10.8	Të gjithë punonjësit e subjekteve të liçensura marrin trajnim për trajtimin e çrregullimeve të rënda të sjelljes. Ekziston dokumenti që vërteton trajnimin.
		10.9	Plani parashikon njoftimin e familjes për incidentin e çrregullimit të sjelljes dhe masat e marra për ndërprerjen e tij.
		10.10	Dosja e personit me aftësi të kufizuara përmban përshkrimin e çdo incidenti të çrregullimeve të rënda të sjelljes dhe masat e marra për ndërprerjen e tyre. Dokumenti është nënshkruar nga drejtuesi i subjektit të liçensuar apo personi përgjegjës për ndjekjen e çrregullimeve të rënda të sjelljes.
11	Planit individual rishqyrtohet së paku një herë në vit.	**11.1**	Çdo person ka në dosje një plan individual që është hartuar jo më parë se një vit.
		11.2	Indidivi ose përfaqësuesi i tij ligjor ka marrë një kopje personale të planit individual.

Standarti 5:

Procedura e shërbimeve

Rezultati përfundimtar i dëshiruar

Personat me aftësi të kufizuara marrin shërbime profesionale me cilësi të mirë dhe që ndjekin procedura të rregullta referimi, vlerësimi, planifikimi dhe të dhënies së shërbimeve. Procedurat respektojnë parimin e vendimmarrjes së mbështetur të përfituesit apo përfaqësuesit të tij ligjor.

Standarti

Subjekti i liçensuar që ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara ka procedura të qarta dhe të rregullta në punën e tij për të gjitha shërbimet e ofruara dhe monitorimin e tyre. Këto procedura janë të dokumentuara dhe të njohura si nga personeli ashtu edhe përfituesit e shërbimeve.

Kriteret e përmbushjes së standartit dhe provat përkatëse:

Kriteret		Prova që vërtetojnë përmbushjen e kriterit	
1	Subjekti i liçensuar ka procedura të qarta dhe të dokumentura për referimin, vlerësimin e aftësive të klientit dhe nevojës për mbështetje, kriteret e përfitimit të shërbimeve, planifikimin e shërbimeve dhe ofrimin e tyre, monitorimin e shërbimeve dhe vlerësimin e efektivititetit të tyre.	**1.1**	Deklarata e qëllimit dhe rregullorja e brendshme përmban kërkesa të cilat përshkruhen me një gjuhë të thjeshtë e sipas nevojes në format të përshtatur për procesin e referimit, vlerësimin e aftësive dhe nevojave për mbështetje të përfituesit, kriteret e përfitimit të shërbimit, planifikimin, ofrimin e monitorimin e shërbimeve si edhe vlerësimin e efektivitetit të tyre me tregues të matshëm.
		1.2	Procedurat nuk prekin dhe kufizojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
		1.3	Procedurat përfshijnë bashkëpunimin me organizata të tjera për të realizuar

			dhënien e shërbimeve të nevojshme për përfituesin.
		1.4	Subjekti i liçensuar ka ndërtuar një sistem për monitorimin e ndjekjes së procedurave.
		1.5	Subjekti i liçensuar organizon anketime periodike së paku një herë në vit me personat që marrin shërbime ose përfaqësuesit e tyre ligjorë. Këto anketime tregojnë kënaqësi me cilësinë e shërbimeve.
		1.6	Intervistat me personat me aftësi të kufizuara ose përfaqësuesit e tyre ligjorë tregojnë që ata janë të kënaqur me cilësinë e shërbimeve.
2	Subjekti i liçensuar siguron që si personeli ashtu edhe përfituesit e shërbimeve apo përfaqësuesit e tyre ligjorë i njohin procedurat.	**2.1**	Personeli është në gjendje të përshkruajë procedurat me fjalët e tyre.
		2.2	Përfituesi apo përfaqësuesi ligjor kanë kopje të procedurave të shërbimeve që marrin në një gjuhë të kuptueshme për ta.
3	Të gjitha procedurat parashikojnë që përfituesi i shërbimeve apo përfaqësuesi i tij ligjor kanë të drejtën e vetëvendosjes dhe vendimmarrjes me mbështetje.	**3.1**	Procedurat përshkruajnë se çfarë mënyre do të kërkohet dhe do të përfshihet mendimi i përfituesit apo përfaqësuesit të tij në procesin e referimit, vlerësimin e aftësive dhe nevojave për mbështetje të përfituesit, planifikimin, ofrimin e monitorimin e shërbimeve si edhe vlerësimin e efektivitetit të tyre.
		3.2	Personeli i intervistuar mund të përshkruajë me fjalët e tij procedurën e përfshirjes së përfituesit duke dhënë shembuj konkretë nga puna në subjektin e liçensuar.

		3.3	Përfituesi i intervistuar apo përfaqësuesi i tij ligjor mund të përshkruajnë me fjalët e tyre procedurën e përfshirjes së përfituesit duke dhënë shembuj konkretë nga përvoja e tyre me subjektin e liçensuar.
4	Subjekti i liçensuar ka procedura të qarta për mbajtjen e dosjeve personale të personave që marrin shërbime bazuar në legjislacionin perkatës.	**4.1**	Çdo përfitues shërbimesh ka një dosje personale.
		4.2	Dosjet personale përmbajnë si minimum formularin e informacionit dhe një fotografi, raportin e vlerësimit, planin individual, raportet e ecurisë, autorizimin e nënshkruar nga personi apo përfaqësuesi ligjor për personat që mund të shohin dosjen apo japin informacion, dhe shënimet mbi shërbimet e marra.
		4.3	Dosjet personale mbahen në një vend të siguruar dhe përmbajtja e tyre është konfidenciale e mund të shihet vetëm nga personat e autorizuar.
5	Subjekti i liçensuar ka procedura të qarta që përcaktojnë trajtimin dhe dokumentimin e incidenteve, aksidenteve dhe emergjencave mjeksore.	**5.1**	Procedurat përshkruajnë rastet që do të përcaktohen si incidente, aksidente dhe emergjenca mjeksore.
		5.2	Procedurat përshkruajnë masat që do të merren në rastet e incidenteve, aksidenteve apo emergjencave mjeksore.
		5.3	Procedurat përshkruajnë njoftimin e familjeve të personave në rastet e incidenteve, aksidenteve apo emergjencave.
		5.4	Në vendin ku ofrohet shërbimi ka një dokument me numrat e telefonit të kontaktit për raste emergjence për çdo pjesëmarrës në program.

		5.5	Ka një dosje ku mbahen raportet e rasteve të incidenteve, aksidenteve dhe emergjencave mjeksore.
6	Subjekti i liçensuar ka procedura të qarta për mbrojtjen nga zjarri dhe fatkeqësive të tjera natyrore dhe shpëtimi prej tyre.	**6.1**	Ka një plan evakuimi në rast zjarri apo fatkeqësish të tjera natyrore që si minimum përcakton rolin e punonjësve, radhën e kryerjes së veprimeve dhe organet që do të kontaktohen.
		6.2	Personeli dhe pjesëmarresit në program bëjnë prova për zbatimin e planit të evakuimit së paku çdo katër muaj.
		6.3	Çdo provë për zbatimin e planit të evakuimit është dokumentuar në dosjen përkatëse. Dokumenti përfshin emrat e pjesëmarrësve në provë.
		6.4	Të gjithë anëtarët e personelit janë trajnuar për detyrat e tyre në rast rreziku nga zjarri apo fatkeqësish të tjera natyrore. Ekziston dokumenti që vërteton trajnimin.
7	Subjekti i liçensuar ka procedura të qarta për mbajtjen dhe dhënien e ilaçeve që mbrojnë personat me aftësi të kufizuara nga abuzimi dhe keqpërdorimi.	**7.1**	Procedurat përcaktojnë që vetëm ilaçet e dhëna me rekomandimin e mjekut mbahen dhe shpërndahen në program.
		7.2	Procedurat përcaktojnë që ilaçet mbahen të mbyllura me çelës që zotërohet vetëm nga personeli i caktuar për shpërndarjen e tyre
		7.3	Personeli i caktuar për shpërndarjen e ilaçeve ka marrë një trajnim mbi procedurat e mbajtjes së ilaçeve dhe shpërndarjes së tyre që mbulon edhe masat që duhen marrë në raste problematike. Ekziston dokumenti që vërteton trajnimin.

		7.4	Subjekti i liçensuar mban shënime të rregullta për shpërndarjen e ilaçeve që si minimum përmbajnë emrin, orën, ilaçin, dozën, mënyrën e. marrjes, dhe emrin e personit që bën shpërndarjen dhe reaksionet e vëna re.
8	Subjektet e liçensuara që ofrojnë shërbime transporti kanë procedura të qarta për to.	**8.1**	Procedurat përcaktojnë që mjeti që përdoret për transport është i siguruar, i përshtatshëm dhe drejtohet nga një person i pajisur me patentë të vlefshme.
		8.2	Procedurat përcaktojnë që çdo person që transportohet udhëton në një sedilie të veçantë me rripin e sigurimit me përjashtim të personave që transportohen në karrocat me rrota për të cilët bëhen rregullime të veçanta.
		8.3	Procedurat përcaktojnë që të gjithë personat në mjet janë nën mbikqyrjen e shoferit apo të një ndihmësi gjatë gjithë kohës së transportit.
		8.4	Personat që bëjnë transportin janë të pajisur me një telefon celular dhe kanë informacionin e duhur për rastet e emergjencave.
9	Qendrat ditore dhe rezidenciale kanë një program aktivitetesh që mbështet planin individual të përfituesve dhe interesat e tyre si edhe përfshirjen në komunitet.	**9.1**	Aktivitetet, që janë të planifikuara, përfshijnë si aktivitete në grup dhe alternativa për aktivitete individuale për personat që nuk janë të interesuar të marrin pjesë në aktivitet në grup.
		9.2	Aktivitetet janë në përputhje me misionin e subjektit të liçensuar dhe mbulojnë fusha të ndryshme.
		9.3	Plani i aktiviteteve hartohet së paku një herë në muaj dhe ai mbulon si aktivitete të

			zhilluara në qendër ashtu edhe aktivitete të zhvilluara në komunitet.
		9.4	Kujdes të veçantë i kushohet planifikimit të aktiviteteve gjithëpërfshirëse së bashku me bashkëmoshatarët pa aftësi të kufizuara.
		9.5	Plani i aktiviteteve afishohet në vend të dukshëm dhe u bëhet i njohur të gjithë pjesëmarrësve të programit.
		9.6	Subjekti i liçensuar ruan kopjet e planeve të aktiviteteve për 12 muajt e fundit.
		9.7	Personat me aftësi të kufizuara përshkruajnë aktivitetet ku kanë marrë pjesë në javën e mëparëshme.
10	Subjekti i liçensuar ka procedura të shkruara si për pranimin ashtu edhe për transferimin apo ndërprerjen e shërbimeve.	**10.1**	Procedurat e pranimit janë shpjeguar qartë dhe ato janë në përputhje me natyrën e shërbimeve të ofruara.
		10.2	Para pranimit, personi ose/dhe përfaqësuesi i tij ligjor vizitojnë mjedisin e shërbimit dhe bëjnë një intervistë paraprake.
		10.3	Para pranimit, subjekti i liçensuar bën një vlerësim paraprak për të vendosur nëse ka mundësi të ofrojë shërbimet e kërkuara.
		10.4	Para fillimit të shërbimit lidhet kontrata midis të dy palëve. Si minimum, kontrata përcakton misionin dhe filozofinë e përkujdesjes, vlerësimin e aftësive dhe nevojave individuale të përfituesve për shërbimet e ofruara, të drejtat dhe detyrimet e përfituesve dhe të personelit, etj.

		10.5	Subjekti i liçensuar ka një listë të personave që kanë kërkuar të marrin shërbime dhe datën e kërkesës. Dokumentacioni i subjektit të liçensuar tregon se periudha ndërmjet datës kur bëhet kërkesa për shërbim dhe datës së ofrimit të tij është e arsyeshme.
		10.6	Procedurat për transferimin dhe ndërprerjen e shërbimeve janë shpjeguar qartë.
		10.7	Transferimi apo ndërprerja e shërbimit është e justifikuar me kërkesën e personit ose pamundësitë e subjektit të liçensuar të ofrojë shërbimet e duhura.

Standarti 6:

Mjedisi i shërbimit dhe ushqimi

Rezultati përfundimtar i dëshiruar

Personat me aftësi të kufizuara marrin shërbime në gjirin e komunitetit në një mjedis të përshtatshëm me natyrën e shërbimit të ofruar, që plotëson të gjitha kushtet higjeno-sanitare dhe kriteret e sigurisë dhe mundësinë për ushqyerje. Mjedisi u jep mundësinë të plotësojnë objektivat e planit të tyre individual për një jetesë të pavarur.

Standarti

Mjedisi i shërbimit reflekton trajtimin e personave me aftësi të kufizuara si qytetarë të barabartë, si nga vendndodhja në komunitet ashtu edhe nga kushtet e plotësuara. Mjedisi për shërbime është i bollshëm dhe i përshtatur për aftësitë e kufizura. Ai plotëson kërkesat bazë higjeno-sanitare, të ndriçimit dhe të mobilimit në përputhje me natyrën e shërbimeve të ofruara dhe të sigurimit e mbrojtjes dhe u krijon mundësi personave me aftësi të kufizuara të plotësojnë objektivat e planit individual. Sa herë që është përshtatëshme, personave me aftësi të kufizuara u merret mendimi për

organizimin dhe mobilimin e tij. Subjekti i liçensuar siguron kushtet për ngrënien e ushqimit, që mund të sillet nga përfituesi apo ofrohet në qendër. Kur ofrohet ushqim, ai garanton plotësimin e nevojave ushqimore të përfituesit në përputhje edhe me kërkesat dietike.

Kriteret e përmbushjes së standartit dhe provat përkatëse:

Kriteret		Prova që vërtetojnë përmbushjen e kriterit	
1	Mjedisi i shërbimit është në gjendje të mirë. Ndodhet në një zonë të banuar, pranë shtëpive të banimit, shkollave, kopshteve, njësive tregtare dhe ato shlodhëse-zbavitëse, etj.	**1.1**	Ndërtesa dhe/apo mjedisi i shërbimit është i mirëmbajtur. Ka dokumentacion të riparimeve, lyerjeve, etj.
		1.2	Vendndodhja dhe dokumentacioni përkatës.
2	Mjedisi i shërbimeve rezidenciale është i ngjashëm me ato të mjediseve familjare, është pajisur si një shtëpi, reflekton shijet e banorëve, ka dhoma të përbashkëta për ndenje, ngrënie e aktivitete dhe u jep mundësinë personave me aftësi të kufizuara të kenë sende të tyre personale dhe të presin miq e familjarë.	**2.1**	Mobilimi i dhomës së gjumit plotëson nevojat jetike të përfituesve dhe siguron mundësinë e përdorimt të të gjitha objekteve prej tyre. Dhoma e gjumit pajiset me krevatë të përshtatshëm, perde, pasqyrë, komo, raft rrobash, tryezë, etj. Mjedisi garanton mbajtjen e sendeve personale.
		2.2	Mjediset e përbashkëta (mjedisi i ngrënies dhe ndenjes) janë organizuar dhe pajisur në mënyrë të ngjashme me mjediset respektive familjare.
		2.3	Mjedisi jep mundësi për pritjen e miqve dhe familjarëve.
		2.4	Personat tregojnë si kanë marrë pjesë në mobilimin dhe organizimin e mjedisit të shtëpisë.
3	Mjedisi i qendrave shumëfunksionale ka mjedise të përshtatshme	**3.1**	Subjektet e liçensuara që ofrojnë shërbime aftësuese dhe riaftësuese kanë dhoma të veçanta për këto

	për të gjitha shërbimet që ofrohen në përputhje me kërkesat e çdo shërbimi.		shërbime të pajisura në mënyrë funksionale.
		3.2	Subjektet e liçensuara që ofrojnë shërbime të formimit profesional dhe punësimit kanë mjedise të veçanta me makineritë dhe mjetet e punës.
		3.3	Qendrat ditore kanë mjedise pune individuale e me grupe, si edhe për aktivitete dhe ngrënie.
		3.4	Të gjitha mjediset e përcaktuara për personat me aftësi të kufizuara janë të përshtatura për të lejuar përdorimin nga të gjithë personat.
4	Mjedisi i shërbimeve plotëson kushtet higjeno-sanitare, të ajrosjes dhe ndriçimit.	**4.1**	Qendra ka furnizim të rregullt me ujë, elektricitet dhe ngrohje dhe freskim.
		4.2	Të gjitha mjediset e përdorura nga personat me aftësi të kufizura kanë dritare apo ventilim.
		4.3	Banjot janë të mjaftueshme për numrin e personave, kanë ujë të rrjedhshëm, mbahen të pastra dhe janë të pajisura me sapun ose solucion larës, letra për fshirjen e duarve dhe letër higjenike.
		4.4	Banjot krijojnë mundësi për të kryer shërbimet e duhura higjeno-sanitare dhe ruajnë intimitetin e duhur.
		4.5	Mjedisi i gatimit dhe i ngrënies plotëson kërkesat higjeno-sanitare përkatëse.
		4.6	I gjithë mjedisi i shërbimeve mbahet pastër dhe plotëson kërkesat higjeno-sanitare.

5	Mjediset janë të siguruara nga zjarri, e nga dëmtimet, kanë dalje në rast emergjence dhe parandalojnë largimin pa leje.	**5.1**	Banesa ka dokumentacionin e inspektimit nga njësia e shërbimit të zjarrfiksave në përputhje me legjislacionin në fuqi.
		5.2	Në mjedise ka sistem alarmi kundër zjarrit që funksionon.
		5.3	Fikëset e zjarrit funksionojnë.
		5.4	Në dhoma, korridoret dhe dyert nuk kanë pengesa ose orendi të mëdha që pengojnë kalimin me lehtësi.
		5.5	Në mjedis ka një kuti funksionale të ndihmës së shpejtë.
		5.6	Dyert e daljes nga mjedisi kanë sistem alarmi apo ruhen. Ka dalje ne rast emergjence.
		5.7	Ka një libër vizitorësh me emrin dhe kohën e të gjithë personave që kanë vizituar mjediset.
		5.8	Largimi pa leje trajtohet si incident.
		5.9	Ka një proces për ndjekjen e përfituesve të larguar pa leje për të cilin janë në dijeni të gjithë punonjësit.
6	Përfituesit marrin vaktet e ngrënies me ushqim që kanë marrë me vete apo që ofrohet nga subjekti i liçensuar.	**6.1**	Ka një orar për ngrënien e ushqimit
		6.2	Në rastet kur ushqimi merret me vete, personeli tregon kujdes që ngrënia e tij të bëhet në kushte të përshtatëshme.
		6.3	Kur ushqimi ofrohet nga qendra, ai ka vlerat ushqimore të kërkuara për grupmoshën dhe plotëson nevojat dietike të veçanta.

		6.4	Kur ushqimi ofrohet nga qendra, përfituesit marrin pjesë në planifikimn e menusë, blerjen dhe përgatitjen e tij, sa herë që kjo është e mundshme.

Standarti 7:

Kërkesat organizative dhe funksionale

Rezultati përfundimtar i dëshiruar

Personi me aftësi të kufizuara merr shërbime nga një subjekt i liçensuar, me një strukturë organizative dhe funksionale që mbështet punën cilësore të punonjësve me kualifikimet e duhura në përputhje me shërbimet e ofruara.

Standarti

Subjekti është liçensuar për të kryer të gjitha shërbimet që ofrohen, ai ka një numër të mjaftueshëm personeli me figurë morale të pastër e kualifikimet e duhura dhe një strukturë organizative e procedura administrative e financiare që mbështesin funksionimin e tij. Subjekti ka kritere për pjesëmarrjen e vullnetarëve.

Kriteret e përmbushjes së standartit dhe provat përkatëse:

Kriteret		Prova që vërtetojnë përmbushjen e kriterit	
1	Subjekti është liçensuar për të kryer të gjitha shërbimet që ofrohen.	1.1	Liçensa është e vlefshme.
		1.2	Të gjitha shërbimet e ofruara janë të liçensuara.
2	Subjekti i liçensuar ka personel të mjaftueshëm e të kualifikuar.	2.1	Numri i punonjësve është i mjaftueshëm për të ofruar shërbimet dhe mbuluar nevojat e personave.
		2.2	Për çdo pozicion në subjektin e liçensuar ka përshkrime pune, ku përshkrohet përgjegjësitë, arsimi dhe trajnimet e kërkuara.

		2.3	Marrja e një punonjësi të ri në punë bëhet me konkurs, në përputhje me legjislacionin përkatës. Gjithashtu, procedurat e punësimit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Kodin e Punës.
		2.4	Të gjithë punonjësit kanë dëshmi penaliteti që vërteton figurën morale të tyre.
		2.5	Subjekti i liçensuar ka dhe realizon një plan trajnimi të detyrueshëm të përvitshëm për të gjithë punonjësit. Si minimum ky trajnim jep njohuri për aftësinë e kufizuar , të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, parandalimin e neglizhencës, abuzimit dhe keqtrajtimit, si dhe për detyra funksionale të punonjësve.
		2.6	Puna e personelit vlerësohet një herë në vit; formulari i vlerësimit firmoset nga punonjësi dhe personi që kryen vlerësimin.
3	Subjekti i liçensuar ka procedura për punësimin e vullnetarëve dhe mbikqyrjen e tyre.	**3.1**	Çdo vullnetar plotëson një aplikim për të punuar me subjektin e liçensuar. Bashkë me aplikimin dorëzohet dëshmia e penalitetit.
		3.2	Kërkesa shqyrtohet dhe aprovohet nga një punonjës i subjektit të liçensuar.
		3.3	Vullnetarët punojnë të mbikqyrur dhe në prezencë të një punonjësi të subjektit të liçensuar.
4	Subjekti i liçensuar ka procedura për drejtimin, ruajtjen e dokumentacionit dhe administrimin financiar.	**4.1**	Drejtuesi i subjektit të liçensuar ka diplomë universitare, njeh problematikën e personave me aftësi të kufizuara dhe ka përvojën dhe

			kualifikimet e nevojshme për të organizuar punën në aspektin administrativ, financiar dhe profesional.
		4.2	Subjekti i licensuar ka procedura për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit në dosjet e përfituesve dhe ato të personelit.
		4.3	Administrimi i dokumentacionit ekonomik e financiar bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

PJESA E TRETË:

SHËRBIMET E PËRKUJDESIT SHOQËROR NË BANESËN E PERSONIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE NË KOMUNITET

Standarti 8:

Shërbimet e përkujdesit shoqëror në banesën e personit me aftësi të kufizuara dhe në komunitet

Rezultati përfundimtar i dëshiruar

Shërbimet e përkujdesit shoqëror në banesën e personit për personat me aftësi të kufizuara dhe në komunitet mbulojnë nevoja të ndryshme funksionale të jetës, fizike, njohëse, psikologjike, komunikative, sociale, aftësuese/riaftësuese-terapeutike, etj., në përputhje me moshën e personit me aftësi të kufizuara dhe nevojat e tij. Shërbimet mbështetëse për familjen parandalojnë institucionalizimin dhe sigurojnë integrimin social pas largimit nga institucioni.

Standarti

Shërbimet e përkujdesjes shoqërore në banesën e personit me aftësi të kufizuara dhe në komunitet realizohen nga persona të kualifikuar dhe të trajnuar për të kryer këto shërbime, të cilët mund të veprojnë si terapistë, asistentë të kujdesit personal, shoqërues, interpretë të gjuhës së shënjave, etj. Marrëdhëniet e punësimit rregullohen me kontrata pune ose marrëveshje shërbimi. Personi me aftësi të kufizuara ose familja e tij merr pjesë në vendimmarrjen për zgjedhjen e personit që i ofron këto shërbime dhe bën vlerësimin e punës së tij. Në përputhje me nevojat, shërbimet për një person apo familje mund të ofrohen nga punonjës të ndryshëm. Shërbimet që mund të plotësohen nga subjekte të liçensuara, apo persona të përzgjedhur nga vetë personi apo familja, janë me cilësi dhe respektojnë të drejtat e njeriut.

Kriteret e përmbushjes së standartit dhe provat përkatëse:

Kriteret		Prova që vërtetojnë përmbushjen e kriterit	
1	Personat që ofrojnë shërbimet e përkujdesjes shoqërore në banesën e personit me aftësi të kufizuara dhe në komunitet kanë kualifikimin ose trajnimin e duhur për të ofruar këtë shërbim.	**1.1**	Personat që punojnë si terapistë kanë diploma universitare në përputhje me natyrën e terapisë së ofruar.
		1.2	Personat që punojnë si asistentë të kujdesit personal ose shoqërues kanë çertifikatë të trajnimit të kërkuar për të kryer shërbimin. Trajnimi i fundit është bërë jo më shumë se një vit përpara. Si minimum, trajnimi përmban njohuri për aftësinë e kufizuar, të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuara dhe shmangien e neglizhimit, abuzimit e keqtrajtimit. Interpretët e gjuhës së shënjave kanë çertifikatën e duhur për të kryer funksionin e tyre.
		1.3	Punonjësi i sektorit të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki/komunë plotëson Kriterin 5 të Standartit 1.
2	Shërbimi në banesë dhe në komunitet rregullohet nga kontrata pune ose marrëveshje shërbimi.	**2.1**	Në rastet e shërbimeve terapeutike ose të asistentit të kujdesit personal, shoqëruesit ose interpretit të gjuhës së shënjave të ofruara nga një subjekt i liçensuar, ka një kontratë pune me subjektin e liçensuar që nënshkruhet nga personi me aftësi të kufizuara apo përfaqësuesi i tij ligjor.
		2.2	Për personat me aftësi të kufizuara që ruajnë përfaqësimin e tyre ligjor, në rastet e shërbimeve të asistentit të kujdesit personal, shoqëruesit ose interpretit të gjuhës së shënjave, të kryera nga një person brenda familjes

			ose një person jashtë familjes, por jo nga subjekte të liçensuara, ka një marrëveshje shërbimi ndërmjet personit me aftësi të kufizuara dhe asistentit të kujdesit personal, shoqëruesit apo interpretit të gjuhës së shënjave. Marrëveshja e shërbimit përfshin dispozita mbi ndërprerjen e marrëdhënies në përputhje me legjislacionin shqiptar të punësimit.
		2.3	Kur shërbimi i asistentit të kujdesit personal, shoqëruesit apo interpretit të gjuhës së shënjave për personin me aftësi të kufizuara, që ka si përfaqësues ligjor një anëtar të familjes, kryhet nga një anëtar i familjes, ka një marrëveshje shërbimi midis personit që ofron shërbimin dhe sektorit të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki/komunë. Marrëveshja e shërbimit përfshin dispozita mbi ndalimin e pagesës dhe kalimin e funksionit të asistentit të kujdesit personal, shoqëruesit apo interpretit të gjuhes së shënjave tek një familjar apo person tjetër.
		2.4	Natyra e shërbimit të përshkruar në kontratë është në përputhje me vlerësimin e nevojave të personit me aftësi të kufizuara dhe pikësynimet e tij për zhvillim e aftësim dhe/ose gjithëpërfshirje në komunitet.
3	Personi me aftësi të kufizuara ose familja e tij merr pjesë në zgjedhjen dhe vlerësimin e punës së personit që ofron shërbimet.	**3.1**	Personi me aftësi të kufizuara ruan të drejtën e zgjedhjes së personit që kryen shërbimin e asistentit të kujdesit personal, shoqëruesit ose interpretit të gjuhës së shënjave, si edhe ndërprerjen e punës së këtij të fundit. Ndërprerja e punës kryhet në përputhje me legjislacionin e punës

			në fuqi. Për shërbimet që nuk ofrohen nga subjekte të liçensuara, procesi i ankimimit kalon ne sektorin e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki/komunë.
		3.2	Një herë në vit bëhet vlerësimi i cilësisë së shërbimit të kryer nga personi që ka nënshkruar kontratën ose marrëveshjen e bashkëpunimit. Për shërbimin e asistentit të kujdesit personal, shoqëruesit apo interpretit të gjuhës së shënjave që nuk ofrohet nga një subjekt i liçensuar, formulari i vlerësimit mbahet në dosjen e personit me aftësi të kufizuara në sektorin e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki/komunë.
4	Sa herë që është e nevojëshme, më shumë se një person mund të punojë me një përfitues. Në këto raste, të gjithë punonjësit bashkëveprojnë për realizimin e planit individual.	**4.1**	Personi me aftësi të kufizuara ose familjari që është përfaqësues ligjor janë të kënaqur me bashkëveprimin.
		4.2	Ka një dosje të vetme për përfituesin. Në dosje ka shënime të takimeve të bëra së paku çdo katër muaj ndërmjet të gjithë personave që punojnë me personin me aftësi të kufizuara dhe këtij të fundit dhe përfaqësuesit të tij ligjor.
5	Shërbimi i kryer është cilësor, në përputhje me planin individual të përfituesit.	**5.1**	Vlerësimi i kryer nga personi me aftësi të kufizuara, familjarët apo punonjësi social i sektorit të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki/ komunë tregon se shërbimi plotëson kërkesat cilësore të përfituesit, të planit të tij individual dhe ato të kontratës së punës apo marrëveshjes së shërbimit.
		5.2	Për shërbimin e kryer nga subjektet e liçensuara, ka një sistem

			mbikqyrjeje dhe vlerësimi pune që është pjesë e rregullores së tyre. Vlerësimi i punës të punonjësit merr parasysh vlerësimin e bërë për të nga personi me aftësi të kufizuara ose përfaqësuesi i tij ligjor.
		5.3	Kur punonjësi social i sektorit të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki/ komunë vëren neglizhim, keqtrajtim apo abuzim të individit me aftësi të kufizuara nga asistenti i kujdesit personal apo shoqëruesi, rasti referohet për inspektim jashtë radhe.
6	Shërbimi terapeutik plotëson të gjitha kriteret e përshtatëshme të shërbimeve komunitare në qendra ditore dhe rezidenciale të Standartit 2 (Kriteret 1, 2, 3, 4, 5), të Standartit 3 (Kriteret 1, 2, 3, 4, 5), të Standartit 4 (Kriteret 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11) , të Standartit 5 (Kriteret 1, 2, 3, 4, 5, 8, 10) dhe të Standartit 7 (Kriteret 1, 2, 3, 4).	**6.1**	Provat janë të njëjta me ato të kritereve të specifikuara.
7	Shërbimet për familjen plotësojnë Kriterin 5 të Standartit 2.	**7.1**	Provat janë të njëjta me ato të Kriterit 5 të Standartit 2.